REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 703/1 Prot.

Vlorë, më 18.05.2017

**Vendim**
**Nr. 11 datë 18.05.2017**

**PËR PËRCAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË.**

Bazuar në nenin 3/ç, 49 dhe 67/1 të ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenin 4/2 i ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "*Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve*", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.05.2017,

**VENDOSI:**

**1.** Masa e shpërblimit mujor për anëtarët e Bordit të Administrimit të jetë 35.000 (tridhjetë e pesë) mijë lekë.

**2.** Masa e shpërblimit mujor të Kryetarit të Bordit të Administrimit të jetë 40.000 (dyzetë mijë) lekë.

**3.** Masa e shpërblimit mujor për sekretarin e Bordit të Administrimit për punën në mbështetje të aktivitetit të Bordit të Administrimit të jetë 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Ky shpërblim ti shtohet pagës mujore që ai përfiton në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

**4.** Anëtarëve të Bordit të Administrimit si dhe sekretarit, të cilët udhëtojnë jashtë vendit të tyre të punës për mbledhjet e Bordit tu rimbursohen shpenzimet e udhëtimit, fjetjes, si dhe trajtimet e tjera/dieta që kryejnë për pjesmarrjet në mbledhje, takime apo aktivitete të tjera.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare që nga dita e konstituimit të Bordit.

**6.** Efektet financiare mbulohen nga fondet e miratuara për vitin 2017.

**7.** Ngarkohet Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me zbatimin e këtij vendimi.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site:www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

1. Rezana Vrapi – Kryetar
2. Ornela Koleka – anëtar
3. Florian Nurçe – anëtar
4. Enida Pulaj – anëtar
5. Marinela Muço – anëtar
6. Elsajed Rexhaj – anëtar
7. Eduard Ahmeti – anëtar

SEKRETARI:

OLSI VANGJELI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site:www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al